



**KOMUNA E KËRÇOVËS**

***PROPOZIMPROGRAMI VJETOR  
PËR PËRKRAHJEN E  
ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL  
TË KOMUNËS SË KËRÇOVËS PËR  
VITIN 2023***

**PROPOZIM-AKTIVITETE PËR REALIZIM NË VITIN  
2023**

korrik, 2023



## **PROGRAMI PËR PËRKRAHJEN E ZHVILLIMI EKONOMIK LOKAL NË KOMUNËN E KËRÇOVËS PËR VITIN 2023**

**Aktivite të parapara për realizim në vitin aktual 2023**



## 1. HYRJE

Zhvillimi ekonomik lokal paraqet veprimtari organizuese të bashkësisë, ku ndërmerren masa dhe aktivitete, forma dhe korniza për zhvillim ekonomik të qëndrueshëm. Zhvillimi ekonomik lokal, ka të bëjë me njerëzit nga bashkësia lokale të cilët bashkëpunojnë midis veti me qëllim të arritjes së rritjes së qëndrueshme ekonomike, që sjellë interes ekonomik dhe përmirësimin e cilësisë së jetës për të gjithë në bashkësi.

Me planifikimin strategjik të Programit për zhvillim ekonomik lokal në Komunën e Kërçovës, komuniteti lokal kryen hapa konkret drejt zyrtarizimit të efekteve të decentralizimit, si proces politik dhe përforsimin e marrëdhënieve demokratike, ndërsa në veçanti përfshirjen demokratike të qytetarëve në procesin e vendosjes.

Zhvillimi ekonomik lokal është kompetencë e vetëqeverisjes lokale dhe në masë të madhe varet nga planifikimi i mirë në vetëqeverisjen lokale. Masat në nivel nacional jo çdo herë janë në mundësi që në mënyrë precize t'i identifikojnë nevojat e komunave në Republikën e Maqedonisë së Veriut, prandaj përgatiten Programe për zhvillimin ekonomik lokal, në nivel të çdo komune, të bazuara në bazë të Strategjive për zhvillim ekonomik lokal të komunave dhe programet për zhvillim të komunave.

Procesi i planifikimit të programit, për dallim nga dokumenti strategjik, nuk është i bazuar sipas pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë nga ana e institucioneve publike, bashkësisë së biznesit dhe shoqërisë qytetare (sektori qytetar, bashkësitë vendore, asociacionet etj.), nga shkak se Komuna e Kërçovë në këtë periudhë, në pajtim me Ligjin për organizim territorial, pësoi ndryshime dhe është e nevojshme periudhë e caktuar për konsolidim, ridefinim të prioritetëve, në pajtim me gjendjen e re të krijuar. Edhe pse, në planifikim, në mënyrë të përgjithshme janë të shqyrtuara nevojat e komunave të cilat u bashkuan drejt Komunës së Kërçovës, dhe përmes përpjekjeve të përbashkëta dhe kontakteve që mundësojnë arritjen e vizionit të përbashkët për krijimin e kushteve për zhvillim të caktuar ekonomik lokal dhe progres të Komunës së Kërçovës, u qas drejt përgatitjes së programit.

Programi për mbështetjen e zhvillimit ekonomik lokal përgatitet dhe miratohet në bazë të kompetencave të vetëqeverisjes lokale, që dalin nga Ligji për vetëqeverisje lokale, Statuti i Komunës së Kërçovës, dispozita tjera pozitive ligjore të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe rekomandimeve të Unionit Evropian për përsheptimin e procesit të decentralizimit dhe krijimin e buxheteve të njësisve të vetëqeverisjes lokale, konformë dokumenteve zhvillimore të planifikuara dhe miratuara në mënyrë transparente.

Përgatitja e programit bazohet sipas vlerësimeve të përpunuara më parë dhe analizave të bashkësisë strategjia dhe planet e komunës në të gjitha fushat tematike ku vetëqeverisja lokale ka kompetenca ligjore ose është në fazën e nivelit të marrjes nga niveli qëndror në atë lokal. Në kuadër të atyre aktiviteteve, është përgatitur profili i Komunës së Kërçovës, i cili duhet vazhdimisht të plotësohet. Megjithatë, përgatitja e programit është në pajtim me udhëzimet e BE-së për shfrytëzimin e IPA fondeve, të cilët në thelb kanë nevojën e zbatimit të kësaj metodologjie për përgatitjen e programeve për punë dhe planifikim buxhetor.

Konformë udhëzimeve dhe detyrimeve të theksuara, në kuadër të Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal të Komunës së Kërçovës, përfshihen edhe programet për punë dhe planifikim buxhetor të të gjitha Sektorëve dhe Seksioneve në Vetëqeverisjen Lokale të Komunës së Kërçovës, me theks të veçantë të Programeve G1, G2 dhe Zhvillimit rajonal, me çka propozohet programi vijues **për Përkrahjen e zhvillimit ekonomik lokal për vitin 2023.**



## 2. BURIME E FINANCIMIT TË PROGRAMIT

Programi do të financohët me mjete financiare

1	<b>Buxheti i Komunës së Kërçovës për vitin 2023 në shumë</b>	<b>12.540.000</b>
2	<b>Fonde ndërkombëtare</b>	<b>3.480.000</b>

### 1. Propozimprogrami për Përkrahjen e Zhvillimit ekonomik lokal të Komunës së Kërçovës për vitin 2023

Komuna e Kërçovës, nëpërmjet Seksionit për zhvillim ekonomik lokal, konformë kompetencave dhe detyrimeve të veta, ndërsa në drejtim të përmirësimit të klimës ekonomike dhe kushteve për zhvillim ekonomik lokal, sipas qëllimeve strategjike të miratuara më parë dhe prioriteteve, e bazon Programin për mbështetjen e zhvillimit ekonomik lokal për vitin buxhetor 2023.

#### 1.1 Operacionalizimi i strategjisë së përhershme për zhvillim ekonomik lokal në drejtim të mbështetjes së zhvillimit ekonomik lokal (mbështetja e OJQ-ve, shoqatat e qytetarëve dhe të ngjajshme, kofinansimi i projekteve dhe aktivitetëve nga interesi i përbashkët)

Operacionalizimi i Strategjisë për zhvillim ekonomik lokal (e cila do të revidohet nëpër sektore) i përfshin planet aksionare vjetore dhe programet për realizimin e aktivitetëve për arritjen e prioriteteve të dhëna dhe qëllimet strategjike, përmes shpalljes së:

#### 1. THIRRJE PUBLIKE PËR FINANSIMIN E PROJEKTEVE NGA LËMIA E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM EKONOMIK LOKAL PËR VITIN 2023

Projekte (mbështetja e organizatave joqeveritare dhe shoqatave të qytetarëve dhe ngjajshëm, kofinansimi i projekteve dhe aktivitetëve nga interesi i përbashkët.)

-Për projektet që ndikojnë në përfundimin e kapacitetit të sektorit qytetar dhe përmirësimin e cilësisë së jetesës së grupeve të ndryshme të qëllimit, në pajtim me drejtimet strategjike dhe përcaktimet e komunës, sipas kriterëve të përcaktuara më parë.

- Për projektet që ndikojnë në përfundimin e kapacitetit të shoqatave dhe OJQ, të cilat punojnë në fushën e përmirësimit të kushteve për jetesë të personave të marginalizuar social, personat me aftësi të posaçme dhe të ngjajshme.



## **Buxheti i paraparë 1.200.000,00den.**

### THIRRJE PUBLIKE PËR FINANSIMIN E PROJEKTEVE NGA LËMIA E ZHVILLIMI TË QËNDRUESHËM EKONOMIK LOKAL PËR VITIN 2023

Për projekte që ndikojnë drejt:

#### **1.2 Krijimi i ekonomisë konkurente në sektorin privat, përkrahjen e zhvillimit të NVM dhe afarizmit**

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, paraqesin fuqi lëvizëse të zhvillimit ekonomik, prandaj, patjetër duhet që në mënyrë të vazhdueshme të punohet për gjetjen e masave stimuluese për hapjen e NVM të reja, por gjithashtu duhet t'u jepet mbështetje edhe ndërmarrjeve ekzistuese në Komunën e Kërçovës, në përpjekjet e tyre që të gjejnë tregje të reja dhe ta përmirësojnë konkurrencën e tyre, me çka do të kontribuohet në zhvillimin ekonomik lokal, në hapjen e vendeve të reja të punës dhe zvogëlimin e papunësisë në Komunën e Kërçovës.

Aktivitetet e parapara për mbështetje, janë në pajtim me politikën zhvillimore kombëtare dhe Strategjinë nacionale për zhvillim të NVM, në kuptimin e krijimit të kornizës së përgjithshme për zhvillim të klimës afariste, Strategjinë për Zhvillim Ekonomik Lokal të Komunës së Kërçovës. Komuna e Kërçovës është në bashkëpunim të drejtpërdrejtë me NVM-të, Dhomat Ekonomike, Agjencinë për punësim dhe institucionet tjera relevante për rrjetëzim dhe promovim të tregut vendor dhe të jashtëm.

Mbështetja e zhvillimit të NVM-ve dhe afarizmit, planifikohet të realizohet përmes aktivitete vijuese:

- Përkrahja e afarizmit, planeve të biznesit, fillimi i start upbiznesevetërejadherealizimiiprojekteveqëkontribuojnëdrejtzvoglimittëpapunësisënë komunë.
- Subvencionimi për punësim të rinjve
- Trajnime për ngritjen e aftësive dhe dijeve (rikualifikim dhe kualifikim shtesë)në pajtim me nevojat e tregut të punës.
- **Nxitja e partneriteteve dhe masave stimuluese si modul për përkrahjen e zhvillimit të NVM dhe afarizmit**
- Përkrahja e NVM për pjesëmarrje në saeme dhe promovime
- Përkrahja e NVM për kualifikim shtesë dhe çertifikim

## **Buxheti i paraparë 5.960.000,00den.**

#### **1.3 Krijimin e kornizës për shfrytëzim të rregullt të resurseve natyrore**



Shfrytëzimi i burimeve njerëzore në funksion të zhvillimit ekonomik lokal, konformë Strategjisë për zhvillim ekonomik lokal në Komunën e Kërçovës, duhet të bazohet në përdorimin racional të burimeve që janë në disponim nëpërmjet aktiviteteve vijuese:

- Nxitjen e markës së prodhimeve dhe shërbimeve në ekonominë lokale, konformë rekomandimeve të BE-së dhe rregullativës ligjore.

Aktiviteti parasheh fillimin e procesit për identifikimin e prodhimeve dhe shërbimeve lokale dhe takimet informative – konsultative me NVM-të dhe prodhuesit lokal.

- Vendosjen e programeve dhe projekteve për përkrahjen e prodhimtarisë organike, mbledhjen e fryteve pyjore, të mbjellura të reja autoktone të pemëve dhe prodhimeve tjera bujqësore.
- Mbështetjen e projekteve dhe programeve lidhur me artizanatet tradicionale dhe autentike (furnizimin ematerialeve dhe mjeteve, rregullimin e hapësirës dhe zhvillimin profesional).
- Mbështetjen e projekteve të cilat kontribuojnë për kursimin e energjisë, përdorimin e energjisë së rinovueshme, mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe afirmimin e tyre.
- **Punëtori edukative informative dhe seminare për mundësitë për shfrytëzimin e mjeteve nga IPARD programi, si dhe për mjetet nga Agjencia për zhvillim rural.**
- Rregullimin dhe shënimin e vendeve për piknik, rrjedhave të ujërave, burime, rrugica për këmbësorët, në funksion të turizmit (nxitjen e zhvillimit të turizmit – G2).
- **Promovimi i mundësive për investim në Komunën e Kërçovës**

### **Buxheti i paraparë 1.000.000,00 den.**

#### **1.4 Mjete për pjesëmarrje vetanake në realizimin e projekteve**

Sipas rregullave të përcaktuara për aplikim për projekte të caktuara, varësisht nga donatori si pashmangshmëri, theksohet nevoja e sigurimit të mjeteve për pjesëmarrje personale, të cilat patjetër duhet të ruhen si kusht i parë për aplikim për projekt të caktuar. Çdo donator cakton kushte të posaçme të cilat vetëqeverisja lokale duhet t'i sigurojë si pjesë integrale e aplikimit për projektin adekuat.

Me këtë shkallë parashihen mjete për pjesëmarrje personale në lëmitë vijuese:

- Pjesëmarrje e Komunës së Kërçovës, për aplikim dhe realizim të **projekteve ndërkombëtare.**

- Pjesëmarrje në finansimin e Qendrës për zhvillim RJPP dhe pjesëmarrjes personale të Komunës së Kërçovës për aplikimin dhe realizimin e **projekteve rajonale** në kuadër të Rajonit Jugperendimor të Planifikuar, konformë Ligjit për zhvillim të barabartë dhe Programin vjetor për finansimin e projekteve rajonale të Byros për zhvillim rajonal.



- Pjesëmarrje e përbashkët në aplikimin dhe realizimin e projekteve me komuna tjera nga Republika e Maqedonisë së Veriut, në kuadër të Programeve të donatorëve të ndryshëm, organizata joqeveritare dhe shoqata, asociacione ndërkombëtare, fonde, ambasada dhe të tjera, për **bashkëpunim ndërkomunal dhe projekte mikrorajonale.**

- Aplikim me projekte që do të kontribuojnë drejt zhvillimit të **infrastrukturës ekonomike të baraspeshuar, komunale dhe sociale**, përmes mbështetjes së programeve të cilat hartohen në pajtim me Ligjin për vetëqeverisje lokale dhe Strategjinë për zhvillim ekonomik lokal, në kompetencat për organizimin dhe menaxhimin me infrastrukturën komunale, si dhe kompetencat e buta, si arsimi, mbrojtja sociale dhe shëndetësore etj.

### **Buxheti i paraparë 7.200.000,00 den.**

#### **1.5 Shpenzime tjera operative vijuese dhe shërbime kontraktuese**

Për realizimin e manifestimeve të Programit për mbështetje të zhvillimit ekonomik lokal për vitin 2023, nevojiten mjete të caktuara të cilat janë të pashmangshme për realizimin e tyre. Këtu, para së gjithash, mendohet në kontratat për shërbime konkrete, me persona juridikë dhe fizikë, ose honorare, pa të cilët nuk mund të realizohen përmbajtjet e parapara të caktuara në vitin 2023.

Suksesi i realizimit të aktiviteteve të projekteve të hartuara të të punësuarëve në Administratën e komunës, të cilët punojnë në fushën e zhvillimit ekonomik lokal, në Seksionin për zhvillim ekonomik lokal, e që janë direkt të lidhur me shkallën e trajnimit të tyre dhe profesionalizmit. Për arsye se, punohet për një problematikë të komplikuar dhe komplekse, konformë standardeve evropiane, patjetër nevojitet që vazhdimisht të ngriten kapacitetet e burimeve njerëzore të të punësuarëve, të cilët punojnë në lëminë e zhvillimit ekonomik lokal.

Dëshmi për rëndësinë e kësaj problematike, është edhe ajo që, në Fondet evropiane paraqasëse (IPA), një komponentë e tërësishme është kushtuar mu për këtë proces, të marrjes së njohurive të reja të vazhdueshme dhe afrimin drejt standardeve evropiane.

Ky program për ngritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore, planifikohet të realizohet përmes:

- Pjesëmarrjes në edukata profesionale, trajnime, seminare, punëtori, konferenca,
- Përthimin e literaturës profesionale, shërbime për kopjim, shtypje dhe botim,
- Shërbime konsultative për aktivitete specifike projektuese,
- Anëtarësi në organizata të jashtme dhe vendase,
- Përgatitjen dhe dizajnimin e projekteve,
- Ridefinimin e Dokumentit për zhvillimin ekonomik lokal dhe publikimin e tij.

### **Buxheti i paraparë 660.000,00 den.**



## Rikapitular

<b>PROGRAMI PËR MBËSHTETJEN E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL NË KOMUNËN E KËRÇOVËS PËR VITIN 2023</b>			
<b>Nr</b>	<b>Aktiviteti</b>	<b>Përshkrim</b>	<b>Shuma</b>
2. 1.	Operacionalizimi i strategjisë për zhvillim të qëndrueshëm -Finansimii mikroprojekteve lokale për zhvillimin ekonomik lokal, në pajtim me strategjinë për zhvillim, përkrahje të OJQ dhe të ngjajshme	Për projektet që ndikojnë në përforcimin e kapacitetit të sektorit qytetar dhe përmirësimin e cilësisë së jetesës së grupeve të ndryshme të qëllimit, në pajtim me drejtimet strategjike dhe përcaktimet e komunës, sipas kritereve të përcaktuara më parë.	900.000,0 0
		Për projektet që ndikojnë në përforcimin e kapacitetit të shoqatave dhe OJQ, të cilat punojnë në fushën e përmirësimit të kushteve për jetesë të personave të marginalizuar social, personat me aftësi të posaçme dhe të ngjajshme.	300.000,0 0
		Gjithsej 2.1.	1.200.000 ,00
2. 2.	Krijimi i ekonomisë konkurente në sektorin privat, përkrahjen e zhvillimit të NVM dhe afarizmit	- Përkrahja e afarizmit, planeve të biznesit, fillimi i start upbiznesevetërejadherealizimiiprojekteveqëkontribuojnëdrejtzvogl imittëpapunësisënëkomunë - Subvencionimi për punësim të rinjve	5.640.000 ,00
		Trajnime për ngritjen e aftësive dhe dijeve (rikualifikim dhe kualifikim shtesë) në pajtim me nevojat e tregut të punës	120.000,0 0
		Përkrahja e NVM për pjesëmarrje në saeme	100.000,0 0





PROPOZIMPROGRAMI VJETOR PËR PËRKRAHJEN E ZHVILLIMIT  
EKONOMIK LOKAL TË KOMUNËS SË KËRÇOVËS PËR VITIN 2023



KOMUNA E KËRÇOVËS

PROGRAMI ZHEL2023

Faqe9nga10

		Përkrahja e NVM për kualifikim shtesë dhe çertifikim	100.000,0 0
		Gjithsej 2.2.	5.960.000 ,00
2. 3.	Krijimin e kornizës për shfrytëzim rregullt të resurseve natyrore	Nxijtjen e markës së prodhimeve dhe shërbimeve në ekonominë lokale, konformë rekomandimeve të BE-së dhe rregullativës ligjore	100.000,0 0
		Vendosjen e programeve dhe projekteve për përkrahjen e prodhimtarisë organike, mbledhjen e fryteve pyjore, të mbjellura të reja autoktone të pemëve dhe prodhimeve tjera bujqësore	100.000,0 0
		Mbështetjen e projekteve dhe programeve lidhur me artizanatet tradicionale dhe autentike (furnizimin ematerialeve dhe mjeteve, rregullimin e hapësirës dhe zhvillimin profesional)	200.000,0 0
		Mbështetjen e projekteve të cilat kontribuojnë për kursimin e energjisë, përdorimin e energjisë së rinovueshme, mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe afirmimin e tyre	300.000,0 0
		Rregullimin dhe shënimin e vendeve për piknik, rrjedhave të ujërave, burime, rrugica për këmbësorët, në funksion të zhvillimit të turizmit	300.000,0 0
		Gjithsej 2.3.	1.000.000 ,00
2. 4.	Mjete për pjesëmarrje vetanake në realizimin e projekteve ndërkombëtare	Pjesëmarrje e Komunës së Kërçovës, për realizim të <b>projekteve ndërkombëtare</b>	300.000,0 0
		Pjesëmarrje në finansimin e Qendrës për zhvillim RJPP dhe pjesëmarrjes personale të Komunës së Kërçovës për aplikimin dhe realizimin e <b>projekteve rajonale</b> në kuadër të Rajonit Jugperendimor të Planifikuar, konformë Ligjit për zhvillim të barabartë dhe Programin vjetor për finansimin e projekteve rajonale të Byros për zhvillim rajonal.	6.000.000 ,00
		Pjesëmarrje e përbashkët në aplikimin dhe realizimin e projekteve me komuna tjera nga Republika e Maqedonisë, në kuadër të Programeve të donatorëve të ndryshëm, asociacione të ndryshme, organizata joqeveritare dhe shoqata, fonde, ambasada dhe të tjera, për <b>bashkëpunim ndërkomunal dhe projekte mikrorajonale.</b>	600.000,0 0



PROPOZIMPROGRAMI VJETOR PËR PËRKRAHJEN E ZHVILLIMIT  
EKONOMIK LOKAL TË KOMUNËS SË KËRÇOVËS PËR VITIN 2023



KOMUNA E KËRÇOVËS

PROGRAMI ZHEL2023

Faqe10nga10

		Aplikim me projekte që do të kontribuojnë drejt zhvillimit të <b>infrastrukturës ekonomike të baraspeshuar, komunale dhe sociale</b> , përmes mbështetjes së programeve të cilat hartohen në pajtim me Ligjin për vetëqeverisje lokale dhe Strategjinë për zhvillim ekonomik lokal, në kompetencat për organizimin dhe menaxhimin me infrastrukturën komunale, si dhe kompetencat e buta, si arsimi, mbrojtja sociale dhe shëndetësore etj.	300.000,0 0
		Gjithsej 2.4.	7.200.000 ,00
2. 5.	Shpenzime tjera operative dhe shërbime kontraktuese	Pjesëmarrje në edukata profesionale, trajnime, seminare, punëtori, konferenca, Përkthimi i literaturës profesionale, shërbime për kopjim, shtypje dhe botim Shërbime konsultative për aktivitete specifike projektuese, Përgatitja dhe dizajnimi i projekteve	100.000,0 0 100.000,0 0 200.000,0 0 60.000,00
		Ridefinimii dokumentit për zhvillimin ekonomik lokal dhe publikimi i tij	200.000,0 0
		Gjithsej 2.5.	660.000,0 0
		<b>BUXHETI I PËRGJITHSHËM PËR 2023</b>	<b>16.020.00 0,00</b>

Përgatiti,  
NjësiapërZHEL

Këshilli i Komunës së Kërçovës  
Kryetar